

Raporti i Konferencës:
Profillet Socio-Ekonomike të Komunave të Rajonit të Prishtinës
Prishtinë, shtator 2020

Ky botim është pjesë e programit të Konzortiumit të OJQ-ve (ATRC, KIPRED, BIRN, SPRC, KCBS dhe D+) “Me Demokraci Pjesëmarrëse për një Kosovë pa Radikalizëm”.

Consortium: "With Participatory Democracy for a Kosovo without Radicalization" | Konzorciumi: "Me Demokraci Pjesëmarrëse për një Kosovë pa Radikalizëm"



Përgatitur nga: Lulzim Peci, Mentor Agani, Diedon Nixha dhe Valdrin Ukshini.

Copyright © 2020, KIPRED. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk bën të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem rikthyes, apo të bartet, në çfarëdo qoftë forme dhe me çfarëdo qoftë pajisjesh, elektronike, mekanike, fotokopjuese, regjistruese, apo të tjera, pa lejen paraprake me shkrim nga botuesi. Luteni të kontaktoni: info@kipred.org apo: +383 38 542 778.

Botuar nga:



Instituti Kosovar për Hulumtim dhe Zhvillim të Politikave (KIPRED)

Rr. Major Mehmet Bushi, H.III. No.1

10 000 Prishtinë, Kosovë

Telefoni dhe faksi: +383 38 542 778

HYRJE

Më datën 28 gusht 2020 në Prishtinë u mbajt Konferenca Rajonale në temën “Profili Socio-Ekonomik i Komunave të Rajonit të Prishtinës,” e organizuar nga Instituti Kosovar për Kërkime dhe Zhvillim të Politikave (KIPRED), me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të Policisë së Kosovës, të udhëheqësive dhe asambleve komunale të komunave të këtij rajoni. Për shkak të gjendjes së krijuar nga pandemia Covid-19, kjo Konferencë u organizua në distancë përmes platformës zoom. Në këtë konferencë u prezantuan dhe diskutuan gjetjet e punimit të KIPRED-it “Profilet Socio-Ekonomike të Komunave të Rajonit të Prishtinës,”¹ diskutim ky që kishte për qëllim të përdoret si nxitje për hapjen e debatit publik, si dhe të ndihmojë vendim-marrësit komunalë dhe kombëtarë për formulimin dhe zbatimin e politikave që do t’i adresojnë nevojat e popullatës së re, më në veçanti të grup-moshës 15–29 vjet. Mungesa e një numri të konsiderueshëm të mysafirëve të ftuar, që pjesëmarrjen e kishin konfirmuar më parë, është arsyeja pse në Konferencë – dhe rrjedhimisht edhe në këtë Raport të Konferencës – një numër i konsiderueshëm i të dhënave që në Profil janë dhanë për disa nga Komunitetet e Rajonit të Prishtinës, nuk u diskutuan fare.

Përndryshe, nga gjetjet e punimit dhe diskutimet e Konferencës janë identifikuar çështjet në vijim që kërkojnë trajtim urgjent nga autoritetet komunale dhe kombëtare.

¹ *Profilet Socio-Ekonomike të Komunave të Rajonit të Prishtinës*, KIPRED, qershor 2020.

KOMUNA E OBILIQIT

Pas pjesës hyrëse të Konferencës, ku organizatori e bëri prezantimin e Profilit Socio-Ekonomik të Komunave të Rajonit të Prishtinës, fjalën e mori zoti Xhafer Gashi, Kryetar i Komunës së Obiliqit, i cili që nga fillimi u përqendrua në të dhënat që në Profilin e Komunave të Rajonit të Prishtinës ishin të paraqitura për Komunën e Obiliqit, duke thënë se edhe pse për disa prej statistikave në Profil thuhet se janë marrë edhe nga komunat, ato, edhe pse mbase nuk janë të pasakta, megjithatë duhet të rikonfirmohen në bashkëpunim me komunat para se të publikohen. Për ta ilustruar këtë pretendim, ai theksoi që te shkollimi dhe infrastruktura shkollore Obiliqi si komunë është i kompletuar. Po ashtu, shtoi ai, ka subvencionime të konsiderueshme në fushat e kulturës dhe të sportit, janë ndërtuar një numër fushash sportive, sallash të edukatës fizike, palestrash sportive, etj., dhe po ashtu subvencionohen të gjitha klubet e shoqëritë kulturo-artistike në komunë. Prandaj, ai tha që nuk e di se si janë nxjerrë statistikat e dhëna në Profil, dhe ato duhet të konfirmohen.

Në qartësimin e dhënë nga organizatori i Konferencës, KIPRED-i, që të dhënat në Profil janë marrë nga buxhetet komunale, përfshirë edhe buxhetin komunal të Obiliqit, z. Gashi shtoi që te subvencionimet për arsim të Komunës së Obiliqit subvencionohen rreth 500 nxënës dhe studentë; janë mbi 240 bursa për studentë, dhe 58 bursa për shkollën e mesme. Po ashtu, nxënësve të komunës së Obiliqit që udhëtojnë u mbulohet transporti, gjithsej rreth 500 veta. Më tutje, Kryetari Gashi shtoi që deri në 2016 Obiliqi ka patur buxhet mjaft të vogël, por në ndërkohë është krijuar një pako për komunat më të varfëra, dhe komuna e Obiliqit ka qenë përfituese. Kështu, në vitin 2015, buxheti i Obiliqit ka qenë 4.7 milionë Euro, dhe në 2020 ai është bërë rreth 11 milionë e gjysmë. Në të gjitha këto, organizatori i Konferencës reagoi duke theksuar që në Profil si bazë është marrë pikërisht buxheti i Komunës së Obiliqit për vitin 2020 dhe se bursat dhe transporti i nxënësve dhe studentëve nuk ishte çështje e shqyrtimit të Profilit. Përgjigja e Kryetarit Gashi ishte që buxheti për vitin 2020 nuk është i përmbyllur, kështu që mund të jetë që në Profil janë përdorur të dhënat e fillimit të vitit 2020, por që mund të jenë ndryshuar në ndërkohë.

Në fund të kësaj pjese të diskutimit, organizatori kërkoi të theksohet se cilat statistika mund të jenë të gabuara, ashtu që ato të përmirësohen. Pas kësaj kërkese, z. Gashi nuk përmendi të dhëna

konkrete statistikore, por theksoi që në Obiliq nuk ka Kishë Protestante, edhe pse në Profil thuhet se është një. Këtu organizatori theksoi që Bashkësia e Komunitetit Protestant të Kosovës, prej ku është marrë kjo e dhënë, e ka konfirmuar që në Obiliq ka Kishë Protestante. Po ashtu, KIPRED-i shtoi që të gjitha të dhënat për objektet fetare nëpër komuna, përfshirë edhe komunën e Obiliqit, i ka marrë nga BIK-u, Kisha Katolike dhe nga Bashkësia Protestante e Kosovës, përfshirë edhe të dhënat që i ka marrë nga OSBE-ja, për objektet fetare ortodokse.

Organizatori në fund e theksoi që gjatë përgatitjes së Profilin me një numër komunash kishte patur bashkëpunim të mirë, mirëpo një numër komuash të tjera nuk iu ishin përgjigjur kërkesave për të dhëna, kështu që KIPRED-it iu është dashur që deri te të dhënat për to të vinte përmes rrugëve alternative. Kështu, për shembull, probleme lidhur me të dhënat për infrastrukturën kulturore dhe sportive kishte patur te mospërgjigja e Drejtoreshës për Kulturë, Rini dhe Sport të Komunës së Obiliqit ndaj kërkesave të KIPRED-it për të dhëna. Për shkak të kësaj, KIPRED-i ka qenë i detyruar që të dhënat për infrastrukturën kulturore e sportive të Komunës së Obiliqit t'i kërkojë nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit. Në komunikimin Kabineti i Kryetarit të Komunës së Obiliqit pati vërejtje me shkrim vetëm për numrin e xhamive, dhe për të dhënat e Agjencionit të Statistikave të Kosovës të cilat në bazë të tyre janë të vjetëruara, dhe për të dhënat e tjera të paraqitura në Profilin e Komunës nuk paten asnjë vërejtje.

Përndryshe, diskutimi pas kësaj vazhdoi lidhur me çështjet e radikalizimit dhe të ekstremizmit të dhunshëm, si dhe të faktorëve që i shkaktojnë ato, si në nivel rajonal, ashtu edhe në atë të Kosovës. Këtu organizatori i Konferencës, KIPRED-i, i përmendi disa përfundime të rëndësishme që dalin nga Profili për të gjitha komunat e Rajonit të Prishtinës, e që janë konfirmuar edhe nga Profilet paraprake të punuara për rajonet e tjera të Kosovës. Kështu, sa i përket raportit të numrit të xhamive me numrin e njerëzve që kanë shkuar në luftrat e huaja, organizatori përmendi që Podujeva i ka 41 xhami, por i ka vetëm 3 luftëtarë të huaj; ndërkaq, Prishtina i ka vetëm 5 xhami më shumë se Podujeva, por i ka dhënë 58 luftëtarë të huaj. Nga kjo përfundohet që shprehja e religjiozitetit nga njerëzit nuk është i ndërlidhur fare me radikalizimin dhe ekstremizmin e dhunshëm. Po ashtu, edhe te Lipjani, që i ka 32 xhami dhe 11 luftëtarë të huaj, nuk ka ndonjë ndërlidhje midis numrit të xhamive e religjiozitetit, me radikalizimin dhe ekstremizmin e dhunshëm.

E njëjta, siç u tha, vlen edhe për nivelin e kriminalitetit. Ky është më i larti në komunën e Graçanicës, edhe pse kjo e paraqet një lokalitet shumë të vogël ku shumica e njerëzve e njohin njëri tjetrin. Ngjashëm vlen edhe për komunën e Fushë Kosovës, që është e dyta në Rajonin e Prishtinës në nivelin e kriminalitetit, me 36 vepra penale në 1.000 banorë. Por, përsëri, nuk ka ndonjë ndërlidhje midis nivelit të kriminalitetit dhe numrit të luftëtarëve të huaj terroristë. Kjo shihet edhe më qartë nga Profilet paraprake, ku në njërin prej tyre është parë që në komunën e Hanit të Elezit niveli i kriminalitetit është shumë i ulët – mirëpo, komuna e Hanit të Elezit ka dhënë një numër shumë të lartë të luftëtarëve të huaj terroristë. Pra, si përfundim, çështja e radikalizimit dhe ekstremizmit të dhunshëm është një që e kërkon një trajtim shumë më kompleks se që duket në shikim të parë.

Po ashtu, për nivelin e rajonit u theksua problemi i nivelit të analfabetizmit. Ky është më i larti në Fushë Kosovë, 59 veta në 1.000 banorë, dhe Fushë Kosova vijohet nga Lipjani e Podujeva. Pjesëmarrësit në Konferencë u pajtuan që shifrat për analfabetizmin janë alarmante, dhe që ato gjithsesi duhet të merren parasysh gjatë planifikimit të politikave lokale.

KOMUNA E PODUJEVËS

Në fjalën e tij, z. Fatmir Gashi, Kryetari i Asamblesë së Podujevës e lavdëroi punimin e Profilit, duke vënë në dukje se sipas mendimit të tij statistikën e dhëna në Profil për Komunën e Podujevës janë përfaqësues të sakta. Ai theksoi se problemet kryesore, sipas tij janë që buxhetet komunale që ndahen për Kulturë, Rini dhe Sport janë të pakënaqshme, si dhe në radikalizimin fetar të një pjese të rinjve në të tërë Kosovën.

Më pas, z. Fatmir Gashi tha që në Podujevë radikalizimi dhe ekstremizmi nuk kanë ndodhur. Kuvendi Komunal këto çështje i diskuton deri në një masë, prandaj, nuk mund të bëhet vërejtje që nuk ka patur debate për këtë çështje. Edhe pse është menduar që të ketë mbledhje të veçanta për këtë çështje, për shkak të numrave të vegjël të rasteve është hequr dorë, dhe temat janë diskutuar vetëm herë pas here, nëpër mbledhjet ku janë diskutuar edhe tema të tjera.

Përndryshe, sukcesi në luftimin e radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm në Komunën e Podujevës, sipas Kryetarit të Asamblesë, Gashi, qëndron në përkushtimin e Komunës – si gjatë kohës së ish-Kryetarit Agim Veliu, ashtu edhe Kryetarit të tashëm, Nexhmi Rudari – për bashkëpunim sa më të madh me komunitetin, me policinë, etj. Ky bashkëpunim ka qenë shumë i mirë dhe ka dhënë rezultate, kështu që, edhe pse komuniteti është pothuaj 100% mysliman, dhe ka numër të madh të xhamive, radikalizimi i të rinjve dhe ekstremizmi i dhunshëm nuk kanë patur sukses. Ai po ashtu u përqendrua në atë që kriminaliteti në komunën e Podujevës është mesatar, gjë kjo të cilën e thekson edhe Profili. Megjithatë, shtoi ai, duhet punuar edhe më tutje, ashtu që numri i rasteve të zvogëlohet edhe më tutje.

Pas kësaj fjale, organizatori i Konferencës e mori fjalën, duke shtuar që KIPRED-i vitin e kaluar e kishte bërë një punim të posaçëm për Komunitat e Podujevës dhe të Suharekës, dhe për nivelin shumë të ulët të radikalizmit në to. Më pas, kjo është krahasuar me Komunitat e Hanit të Elezit dhe të Kaçanikut, që e kanë pasur nivelin më të lartë të radikalizmit në Kosovë. Përfundimi që është nxjerrë në këtë punim ka qenë që në Podujevë dhe në Suharekë ishte krijuar trekëndëshi i bashkëpunimit midis qeverisë komunale, Policisë së Kosovës, dhe Bashkësive Islame Lokale të Kosovës, dhe ky bashkëpunim ka qenë kyç në luftimin e dukurisë, dhe në moslejimin e futjes së rrymave radikale e

ekstremiste në këto komuna. Me këtë, siç kishte konstatuar ky punim, Podujeva dhe Suhareka e kanë dhënë një model dhe shembull se si duhet të veprohet për t'u përballur me këtë dukuri. Në fund, organizatori i Konferencës vuri në dukje për pjesëmarrësit që për këtë punim të posaçëm kishin treguar interesim të madh institucione të shumta, shumë prej të cilave ishin ndërkombëtare, si në Kosovë, ashtu edhe jashtë. Ato kishin qenë shumë të interesuara për përfundimin e punimit që bashkëpunimi në trekëndëshin e sipërpërmendur, Qeveri Komunale – Polici – Bashkësi Islame Lokale, është vital për ta luftuar ekstremizmin e dhunshëm.

Pas kësaj, Kryetari i Asamblesë Komunale të Podujevës, z. Fatmir Gashi, e shprehi pajtimin e tij për funksionimin shumë të mirë të këtij trekëndëshi në komunën e Podujevës, si dhe shpresën që një trekëndësh i tillë do të funksionojë mirë edhe në komunat e tjera të Kosovës. Ai po ashtu tha që Profili edhe për çështjet e tjera tregon se ku jemi dhe si qëndrojmë, dhe se duhet të merremi seriozisht me to në politikat komunale, ashtu që të përmirësohen të gjitha çështjet e përmendura në këtë punim.

Pas Kryetarit të Asamblesë, z. Fatmir Gashit, fjalën e mori Zëvendës Drejtori Rajonal i Drejtorisë së Policisë së Kosovës për Rajonin e Prishtinës, Nënkoloneli Gëzim Dibrani, i cili e lavdëroi punën e bërë në Profil. Ai theksoi që edhe tema e për zgjedhur, dhe edhe grup-mosha e targetuar në hulumtim janë shumë të rëndësishme për sektorin e sigurisë.

Nënkoloneli Dibrani tha që, sipas mendimit të tij, të dhënat e prezantuara janë të sakta, mirëpo, për ta patur një pasqyrë më të qartë të kriminalitetit në një zonë, të bazuar në statistika, duhet që këto statistika të jipen për një periudhë prej tri vitesh. Në këtë mënyrë fitohet përshtypje jo vetëm për gjendjen e kriminalitetit, por edhe për dinamikën, dhe, rrjedhimisht, edhe tendencat e tij. Meqë më parë u ngrit çështja e të dhënave për Komunën e Obiliqit, Nënkoloneli Dibrani tha që ai do ta shqyrtojë të dhënë për kriminalitet në Komunën e Obiliqit në Profil, 48 vepra penale për 1.000 banorë, dhe që pas kësaj do ta dërgojë përfundimin e tij për këtë çështje.

Ai më pas theksoi se radikalizimi dhe ekstremizmi i dhunshëm vazhdojnë të jenë një sfidë dhe prioritet i Policisë së Kosovës. Ai u përqendrua po ashtu në atë që u përmend që institucionet fetare si të tilla nuk janë burim i terrorizmit. Përkundrazi, shtoi ai, BIK-u e ka dhënë një ndihmë të konsiderueshme në parandalimin e veprave terroriste dhe në trajtimin e personave që janë kthyer nga luftat e jashtme.

Nënkolonel Dibrani po ashtu u përqendrua në faktin e përmendur në Profil që Kuvendet Komunale në asamblatë e tyre nuk e kanë diskutuar asnjë herë çështjen e radikalizimit dhe të ekstremizmit të dhunshëm. Ai theksoi që Policia e Kosovës, pos Strategjisë kundër Terrorizmit, e ka edhe Strategjinë e Sigurisë në Bashkësi 2017–2021, thelbi i të cilës qëndron në bashkëpunimin me komunitet në parandalimin e të gjitha veprimtarive kriminale, pos tjerash edhe ekstremizmit të dhunshëm. Dhe, nga ana tjetër, në Forumet e Sigurisë Lokale, ku udhëheqës janë Kryetarët e Komunave, këto çështje debatohen, dhe ata janë të informuar për to.

Përndryshe, lidhur me Forumet për Siguri Lokale, KIPRED-i theksoi që është pjesë e forumit që ka të bëjë me zbatimin e strategjisë së luftës kundër radikalizimit dhe për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm, dhe që ka qasje në raportet e deklasifikuara të Këshillit për Siguri Kombëtare, dhe është i njoftuar për atë se çfarë bëhet në çdo komunë. Kjo qëllimisht nuk është vënë si pjesë e këtij raporti, edhe pse KIPRED-i e di që kryetarët e komunave i udhëheqin ato. Edhe përkundrejt kësaj, KIPRED-i theksoi që problemin që e ka është që politika në nivelin komunal nuk është duke u marrë me këtë çështje.

KOMUNA E DRENASIT

Në fjalën e saj, Egzona Jetullahu, Drejtoreshë e Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik në Komunën e Drenasit në fillim tha që ajo është e pranishme në këtë Konferencë për shkak të mungesës së Kryetarit të Komunës, z. Ramiz Lladrovci, dhe shtoi që për këtë është informuar sot, dhe është lutur që ta zëvendësonte Kryetarin Lladrovci. Për këtë arsye ajo kërkoi falje që nuk ka qenë në gjendje që deri në fillimin e Konferencës ta lexojë të tërë Profilin, por sidoqoftë e lavdëroi Profilin për pjesët që i kishte lexuar.

Znj. Jetullahu e shprehu dëshirën që ta ketë mundësinë që të dhënat për Komunën e Drenasit të konfirmohen më detajisht. Për këtë ajo ceku që punimi i trajton të dhënat për buxhetet nga niveli qendror, pra buxhetet që janë të përcaktuara për nivelin komunal. Pastaj ajo shtoi që Komuna e Drenasit ka subvencione të mëdha që shkojnë për kulturë, si dhe për arsimim, në nivelet më të ulëta të shkollimit. Kështu, ajo theksoi që Drenasi është komuna e parë që, përmes aplikacionit Google Maps e ka bërë dixhitalizimin e të dhënave për numrin e të shkolluarve në çdonjërin pjesë të Komunës së Drenasit, kështu që këto të dhëna janë në dispozicion për të gjithë.

Prandaj, Drejtoresha Jetullahu e shprehu dyshimin nëse të dhënat që janë marrë nga niveli qendror korrespondojnë me aktualet që janë në dispozicion, kështu që ajo e parashtrroi kërkesën që para publikimit final të Raportit të ofrohet mundësia që të dhënat të rishikohen edhe një herë, dhe nëse ka propozime për ndryshime, këto do të dërgohen.

Lidhur me këtë, znj. Jetullahu i përmendi subvencionimet nga grantet që merren për t'u dhënë për sektorin e kulturës, por po ashtu edhe ato që jipen për ekonomi dhe bujqësi. Këto, shtoi ajo, mund të shqyrtohen me Nënkryetarin e Komunës, zoti Nazmi Hasin, meqë Kryetari nuk mund të jetë për shkak të gjendjes së tij shëndetësore. Në fund ajo theksoi që do të jetë në kontakt me zoti Hasin, si dhe me të gjithë drejtorët e Kuvendit Komunal të Drenasit, dhe që pikat do të shqyrtohen detajisht, dhe nëse ka komente shtesë ato do të dërgohen. Me këtë rast organizatori shtoi që nëse komuna ka të dhëna edhe më të specifikuar se niveli qendror, ato do të jenë të mirëseardhura, dhe vetëm që do ta bëjnë Raportin edhe më të kompletuar. Mirëpo, duhet theksuar se propozimet për ndryshime eventuale në Profilin e Komunës nuk u dërguan nga Komuna e Drenasit.

KOMUNA E LIPJANIT

Nënkryetar i Komunës së Lipjanit. z. Fauz Xhemajli nuk bëri ndonjë diskutim të të dhënave të Profilit, mirëpo në komentin e tij theksoi që Profili, si një raport, është një themel i mirë për të vazhduar. Të dhënat e grumbulluara në këtë Profil, theksoi ai, tregojnë se ku jemi dhe si qëndrojmë. Sipas tij, shkalla e analfabetizmit është tejet shqetësuese, dhe çdonjëra Komunë, si e tillë, duhet ta merr përgjegjësinë për pjesën që i takon asaj. Kjo, sipas tij, po ashtu vlen edhe për të gjitha çështjet e tjera të trajtuara në Profil – për shkallën e radikalizimit fetar, atë të punësimit, të gjendjes sociale, të kulturës, etj. Kudo ku ka nevojë për të intervenuar, sipas Xhemajlit, Komunitat duhet t'i zhvillojnë dhe zbatojnë politikat e domosdoshme përkatëse.

REKOMANDIME:

- Institucionet nacionale dhe ato komunale duhet t'i kushtojnë kujdes dhe të ndërmarrin masa për uljen e nivelit të analfabetizmit në komunat përkatëse, i cili ka ndikim të drejtëpërdrejtë në zhvillimin lokal dhe gjendjen socio-ekonomike.
- Asambletë komunale dhe partitë politike në nivel lokal duhet të marrin përgjegjësi në luftimin e radikalizimit dhe preventimin e ekstremizmit të dhunshëm.
- Komunitat duhet të rrisin në mënyrë substanciale buxhetet për përkrahjen e aktiviteteve rinore.
- Autoritetet komunale dhe Policia e Kosovës duhet të ndërmarrin masa të përbashkëta në uljen e nivelit të kriminalitetit në nivel lokal.